



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.23/2023

Nr. Protokoll: 34/2023

Për:	Refki H. Bytyçi B.I., Rruga "Brigada 123", 23000, Suharekë
Kopje:	Z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Fatos Kuqi Shef i zyres se Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	25.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, **Kerkeses për Rishqyrtim** të derguar në Platforme Elektronike të datë: **19.04.2023** të parashtruar nga "**Refki H. Bytyçi B.I., Rruga "Brigada 123", 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet e transportit të nxënësve për vitin 2023-2024 4 lot - RITENDER**, me Nr. të Prokurimi: **624-23-2427-2-2-1 & 624-23-15-221** nxjerr këtë::

V E N D I M

- I. **Aprovohet Pjesërisht** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 19.04.2023 të parashtruar nga operatori ekonomik: **Refki H. Bytyçi B.I., Rruga "Brigada 123", 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet e transportit të nxënësve për vitin 2023-2024 4 lot - RITENDER**, me Nr. të Prokurimi: **624-23-2427-2-2-1 & 624-23-15-221** nxjerr këtë:
- II. **Anulohet njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 18.04.2023 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 19.04.2023 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik " **Refki H. Bytyçi B.I. Rruga "Brigada 123", 23000, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet e transportit të nxënësve për vitin 2023-2024 4 lot - RITENDER,**

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për ri-shqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se pretendimet tuaja qendrojnë dhe si i till, ky aktivitet kthehet në ri-vlerësim ,

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

